



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 36, 37, 38, 39 dhe 40 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në bordin e Ndërmarrjes Publike Posta e Kosovës Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Halit Isufi, Kryesues;
 - 1.2. Mejdin Xhokli;
 - 1.3. Hysen Fazliu;
 - 1.4. Branislav Nikolić;
 - 1.5. Metije Jashari dhe
 - 1.6. Rushan Ceka.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vite.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAJA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në bordin e Ndërmarrjes Publike Aeroporti i Gjakovës, Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Brikenda Kryeziu, Kryesuese;
 - 1.2. Naser Canolli;
 - 1.3. Nora Gola;
 - 1.4. Nuri Bahtijari;
 - 1.5. Zenun Shala.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vite.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë në bordin e Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës - INFRAKOS, Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Enver Aruqaj, Kryesues;
 - 1.2. Nijazi Selmani;
 - 1.3. Fëllënëza Xhelili;
 - 1.4. Miloš Dimić;
 - 1.5. Milazim Bytyçi dhe
 - 1.6. Nexhat Dedia.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin nr. 05/L-009, si dhe legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë tre (3) vite.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma për lidhjen e Marrëveshjes Rajonale për themelimin e Qendrës së Ballkanit Perëndimor për Hulumtime dhe Inovacione.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për transport rrugor ndërkombëtar të udhëtarëve dhe mallrave ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Norvegjisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet Ministria e Infrastrukturës që të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/48

Datë: 09.09.2015

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për rishikimin e ndarjes së shtesave të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës

1. Të gjitha shtesat të cilat realizohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës me vendime të veçanta nga institucione të ndryshme do të rishqyrtohen deri më 15.10.2015 dhe miratohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës sipas kësaj procedure;
 - 1.1. Zyra e Kryeministrit, ministrisë dhe organet vartëse të tyre që cilat kanë propozuar vendime të Qeverisë për shtesa, e të cilat janë aprovuar nga Qeveria, duhet të bëjnë kërkesë për ndryshimin, plotësimin apo vazhdimin e tyre.
 - 1.2. Institucionet tjera jashtë ekzekutimit për realizimin e shtesave për nëpunësit e tyre duhet të paraqesin kërkesë në Ministrinë e Administratës Publike për realizimin e shtesave mbi pagën bazë, Ministria e Administratës Publike do t'i vlerësojë kërkesat nga pika 1.2. dhe i propozon Qeverisë aprovimin e shtesave mbi pagën bazë.
2. Kërkesave për shtesa mbi pagën bazë nga pika 1.1. dhe 1.2. duhet t'i bashkëngjiten edhe opinionin e Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Administratës Publike.
3. Përfituesit e shtesave do të përcaktohen me vendim. Kërkesat për përfituesit do të shqyrtohen dhe miratohen paraprakisht nga komisioni i përbashkët i themeluar nga Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave.
4. Deri në rishqyrtimin e vendimeve sipas pikës 1. të këtij vendimi, të gjitha pagesat e shtesave pezullohen deri më 30 tetor 2015, përveç shtesave të përcaktuara në shtojcën I. të këtij vendimi.
5. Të gjitha shtesat të cilat janë pezulluar përkohësisht, pas rishqyrtimit sipas pikës 1. të këtij vendimi, jepen në mënyrë retroaktive për përfituesit.
6. Lartësia e të gjitha shtesave mbi pagën bazë, në asnjë rast nuk mund të kalojë 40% të pagës bazë të një nëpunësi.

7. Obligohen të gjitha Institucionet për zbatimin e këtij vendimi, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Financave janë të obliguara të japin udhëzimet e hollësishme për të gjitha institucionet për zbatimin e këtij vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Shtojca I

Nr.	Lloji i shtesës
1	Shtesa për kualifikimet në arsim sipas vendimit të Qeverisë Nr.01/33 të datës 29.08.2008
2	Kompensime për ndërrimet e natës dhe kujdestari
3	Kompensime për stafin akademik
4	Shtesa për shërbimin civil (30)
5	Shtesat për rrezikshmëri në punë
6	Shujtat
7	Shtesë në Shëndetësi (44)
8	Shtesa për pjesëmarrje në Seancë të Kuvendit të Kosovës
9	Shtesat për Prokurorinë Speciale
10	Shtesat për AKI
11	Shtesa sipas Udhëzimit Administrativ për Masat dhe shtimin e efikasitetit në Administratë Publike
12	Shtesë funksionale për anëtarët e Këshillave Drejtuese në Universitet Publike
13	Shtesa për përvojën e punës